



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 15.11.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:17 dhe mbaroi në orën 13:53.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

***Shënim 1:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.***
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.***
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI).***
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).***
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

***Ilir Rusi:*** Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sipas njoftimit të bërë por edhe ndryshimit të rendit të ditës në lidhje me vendimmarrjet që ka marrë ky Këshill ditën e djeshme, deklaroj të hapur mbledhjen e datës 15.11.2023, ora 10:00.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është në angazhime institucionale dhe e ka të pamundur objektivisht për të qenë pjesë e kësaj mbledhjeje, kështu që, mbledhja në vijim do të vijohet nga ana ime Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke iu referuar rendit të ditës, kemi çështje të cilat shqyrtohen “Online” dhe në komunikim me të tretët dhe çështje të cilat për shkak të karakterit të tyre janë me të dhëna sensitive dhe shqyrtohen me dyer të mbyllura.

Ka ndonjë diskutim me rendin e ditës?

Meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së parë të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Rupa.

***Yllka Rupa:*** Faleminderit!

Të nderuar kolegë!

{...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka paraqitur kërkesë përpara Këshillit për të kërkuar leje të papaguar për arsye familjare në kuptim të nenit 24, paragrafi 3 i ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", si dhe Vendimit nr.72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Arsyeja për të cilën kërkon përfitimin e lejes së papaguar lidhet me përgjegjësinë për mirërritjen dhe kujdesin ndaj fëmijës së mitur.

Gjyqtarja pohon se aktualisht fëmija ushqehet me gji dhe kjo kushtëzon praninë për të qenë të paktën për një periudhë 9-mujore pranë fëmijës. Gjykata ku unë jam caktuar të ushtroj funksionin gjendet në një distancë të konsiderueshme nga vendbanimi im, e për këtë arsye është e pamundur që të ushtrohet njëkohësisht funksioni edhe përkujdesja ndaj fëmijës së mitur.

Lidhur me këtë kërkesë Komisioni vlerëson se nga informacioni i marrë nga dosja personale e gjyqtarës, rezulton se {...} është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 558, datë 12.10.2023 nga KLGJ, dhe është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me vendimin nr.598, datë. 19.10.2023.

Kërkesja {...} ka paraqitur kërkesën e sipërcituar pasi periudha trevjeçare e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, nuk konsiderohet periudhë punësimi dhe nuk llogaritet si e tillë në momentin e caktimit në pozicion që të mund të përfitonte lejen e lindjes sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore".

Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zhvilloi procedurën ku u kërkuar ndër të tjera mendimi i Zv/Kryetarit të gjykatës si dhe u kërkuar informacion nga kancelarja e gjykatës në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve. Zv/Kryetari i

Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, e lë në vlerësim të Këshillit trajtimin e kësaj kërkesë, ndërsa kancelarja e gjykatës paraqiti informacionin e kërkuar në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Përgjithshëm Lezhë, në lidhje me organikën e gjykatës në të cilën rezultojnë të jenë efektiv 8 gjyqtarë, nga të cilët 6 gjyqtarë të emëruar rishtazi, si dhe ngarkesën aktuale të gjyqtarëve, duke përcaktuar numrin e çështjeve në gjykim për secilin prej tyre.

Lidhur me lejen e papaguar në nenin 24 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se magjistrati mund të përfitojë leje prindërore ose pushime të tjera. Në këtë nen parashikohen disa kritere për dhënien e lejes së papaguar nga Këshilli dhe njëkohësisht parashikohet se: “Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar”.

Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, neni 24 të ligjit nr.96/2016 dhe vendimi nr.72 datë 20.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor në pikën 4 parashikojnë tre lloje të lejes:

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimin vazhdues;
- c. Leje për arsye familjare dhe/ose shëndetësore.

Lidhur me kushtet për dhënien e lejes për arsye prindërore, sipas pikës 5 të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, leja prindërore i jepet nga Këshilli gjyqtarit që ka ushtruar funksionin më shumë se një vit në mënyrë të pandërprerë. Nisur nga ky parashikim, znj. {...}, nuk mund të përfitojë leje prindërore të papaguar.

Nga ana tjetër, ndodhur në kushtet ku shkak i kërkesës së saj është bërë ardhja në jetë e fëmijës, i cili aktualisht është në moshën 4 muajsh, Komisioni vlerëson se në këtë rast, në respektim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, Legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore, leja e papaguar, e kërkuar për këtë arsye, nuk mund të refuzohet.

Parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës sanksionohet në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të drejtat e fëmijëve në të cilin përcaktohet se: “Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”. Në respektim të këtij parimi, Kodi i Familjes parashikon dhe rritet detyrimin për respektimin e interesit më të lartë të fëmijës në një sërë dispozitash të tij ndër të cilat neni 2 parashikon se: “Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës”.

Ligjvënësi me qëllim përafrimin e legjislacionit me Direktivat e BE-së, ka ndryshuar Kodin e Punës, kështu që parashikon në nenin 104 të tij ndalimin e punës për gratë shtatzëna dhe nënat e reja. Nga përmbajtja e kësaj dispozite qartazi përcaktohet që grave shtatzëna, 35 dite para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes, ju ndalohet të punojnë. Pas përfundimit të kësaj periudhe, gruaja që sapo ka lindur dhe /ose gruaja me fëmijë në gji, vendos vetë nëse do të shkojë në punë.

Gjithashtu një përcaktim të tillë ka edhe ligji “Për sigurimet shoqërore”, kështu që ligji parashikon se periudha e përfitimit nga paaftësia për shkak të barrë lindjes zgjat derisa fëmija të mbushë 11 muaj. Në frymën e këtij përcaktimi interesi më i lartë i fëmijës kërkon domosdoshmërinë e kujdesit amësor deri në një periudhë 11-mujore pas ardhjes në jetë të fëmijës.

Në analizë të parashtrimeve të mësipërme, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, vlerëson se: gjyqtare {...}, duhet të trajtohet me leje të papaguar derisa i mituri të mbushë 9 muaj, për ushtrimin e të drejtës parësore për të ruajtur dhe garantuar jetën dhe shëndetin e fëmijës. Në situatën faktike interesi më i lartë i fëmijës dikton kujdesin e pashmangshëm të nënës si në aspektin e nevojave fiziologjike, ushqimit me gji, ashtu edhe në aspektin e nevojave emocionale të fëmijës dhe nënës gjithashtu. Duke pasur në vëmendje specifikat e lejes së papaguar e cila në thelb aplikohet për të garantuar ruajtjen e vendit të punës për gjyqtarin, gjykohet se për shkak të interesit më të lartë të fëmijës, gjyqtares duhet t’i garantohet e drejta për ruajtjen e

pozicionit dhe sigurisht të lejohet të ushtrojë funksionin primar të kujdesit ndaj fëmijës.

Pavarësisht gjendjes së sistemit për shkak të vakancave të krijuara, Komisioni vlerëson se, leja e papaguar për gjyqtaren nuk mund të kushtëzohet nga cenimi apo jo i funksionalitetit të gjykatës kështu që ajo duhet të përfitojë të drejtën derisa fëmija të mbushë 9 muaj.

Komisioni vlerëson se në rastin konkret “leja e papaguar”, nuk përbën “leje prindërore” dhe as zgjatje e afatit të lejes së dhënë më herët për arsye familjare, tej atij 2-vjeçar, të parashikuar nga neni 24 i Ligjit “Për statusin”, i ndryshuar. Këshilli ka detyrimin pozitiv të parashikuar nga neni 54 i Kushtetutës t’i garantojë mbrojtje të veçantë gjyqtares si nënë e re, por edhe fëmijës së sjellë në jetë prej saj.

Në këto kushte Komisioni propozon miratimin e kërkesës së zonjës {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për dhënie leje të papaguar deri në datë 31.03.2024.

Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afatit ligjor.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë pasi botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Mbi kërkesën e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, Gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për dhënie leje të papaguar për arsye familjare deri më datë 31.03.2024.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 15.11.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, (të datave: 13.09.2023, 21.09.2023 dhe 28.09.2023).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:17 dhe mbaroi në orën 13:53.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |



***Shënim 1:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.***
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.***
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI).***
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).***
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, (të datave: 13.09.2023, 21.09.2023 dhe 28.09.2023).

***Ilir Rusi:*** Vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 13.09.2023, 21.09.2023 dhe 28.09.2023.

Keni diskutime mbi përmbajtjen e tyre?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin në lidhje me miratimin e tyre.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Ilir Rusi*: Dakord.

Vendim “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 13.09.2023, 21.09.2023 dhe 28.09.2023.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sikundër e bëra me dije në fillim të kësaj mbledhjeje, disa çështje janë të karakterit publik, që mund të dëgjohen nga të tjerët, disa çështje janë të një karakteri për t’u diskutuar me dyer të mbyllura. Kështu që, rendi i ditës në lidhje me çështjet e hapura përfundoi. Do vazhdojë më tej në lidhje me diskutimin e mbledhjes me dyer të mbyllura.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**